



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2022

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

T I R A N Ë

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Drejtuar: **“Blerina Sadiku” sh.p.k** me adresë: Berat Perondi MAGJATE Godinë 1 katëshe në Magjatë pranë ish-uzinës së aviacionit.

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur e thjeshtuar”**.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-47676-10-27**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje uniforma dhe veshje per Sherbimin e MSZH-se dhe strukturat Vullnetare”**, me fond limit: **1.391.770** (një milion e treqind e nentëdhjetë e nje mije e shtatëqind e shtatëdhjetë) **lekë pa t.v.sh** vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan, dhe me afat për levrimin e mallit **30 ditë nga data e lidhjes së kontratës.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [data] [nr]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “Blerina Sadiku” P.F me Nipt: K97730102T

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1,374,700** (një milion e treqind e shtatëdhjetë e katërmijë e shtatëqind) lekë (pa tvsh).

2. “Enea Masllavica” P.F me Nipt: L71920001R

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1,275,790** (një milion e dyqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) lekë (pa tvsh).

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

1. “Enea Masllavica” P.F

1. Nuk kishte paraqitur *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, duke mos permbushur kriteret e përgjithshme të perzgjedhjes/kualifikimit sipas shtojcës 7.*

2. Nuk permbushte piken 2.3.3, shtojca 7, kapaciteti teknik, për arsye se: disa nga mostrat e paraqitura nga subjekti juaj nuk janë në përputhje me specifikimet teknike e konkretisht:

a) Mostra e paraqitur për artikullin Xhakete për kostumin e verës nuk ka etiketen përshkuese të materialit duke e pamundësuar verifikim për përputhshmërinë e materialit me specifikimet teknike.

b) Mostra e paraqitur për artikullin Bluze me mëngje të gjata pambuku (jaka sportive) për kostumin e verës nuk ka etiketen përshkuese të materialit duke e pamundësuar verifikim për përputhshmërinë e materialit me specifikimet teknike.

c) Mostra e paraqitur për artikullin Felpa dimërore për kostumin e dimrit është pa xhepa në kundërshtim me specifikimet teknike ku kërkohet që ajo të jetë *me dy xhepa anësore me mbyllje me zinxhir.*

Është barrë e operatorëve ekonomikë që të provojnë se disponojnë kapacitetet e duhura për të zbatuar me sukses dhe cilësinë e kërkuar kontratën objekt prokurimi dhe në rastet kur me anë të dokumentacionit të paraqitur këta të fundit nuk arrijnë të provojnë disponimin e kapaciteteve të kërkuara, ofertat e tyre duhet të refuzohen si të papranueshme.

3. Nuk permbushte piken 2.3.4, shtojca 7, kapaciteti teknik, për arsye se: nuk keni paraqitur autorizim/kontratë bashkëpunimi/furnizimi nga prodhuesi/distributori, për setin e kostumit të verës dhe setin e kostumit të dimrit, shoqëruar me deklaratë konformiteti CE.

Oferta e operatorit ekonomik “Enea Masllavica” P.F s’kualifikohet per arsyen e mesiperme.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **“Blerina Sadiku” sh.p.k** me adresë: Berat Perondi MAGJATE Godinë 1 katëshe në Magjatë pranë ish-uzinës së aviacionit, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej **1,374,700** (një milion e treqind e shtatëdhjetë e katërmijë e shtatëqind) lekë (pa tvsh), është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Aulona Bylykbashi**